

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
(Sektori i Financës)

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, Albania, nr.tel. & fax. 00355 218 229 37

PROJEKT-VENDIM

Nr. 09 Datë 25/03/2024

"Për Përdorimin e Fondit Rezervë, nga Granti & Të Ardhurat"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe ligjit nr.97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.139 datë 29.12.2023, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.24/1 prot. datë 11.01.2024 :

KËRKOJMË:

- I. Nga fondi rezerve, të planifikuara nga Granti & te Ardhurat, t'u jepet ndihmë financiare për mbështetje financiare për Gjimnazin "Fiqiri Dine" Maqellarë për pjesëmarrje në "Festivalin e XXIX Kulturor Folklorik të Kalabrisë, Itali dhe Teknofest 2024, Stamboll, Turqi" sipas kërkesës nr.9/6 prot. datë 19.02.2024, e protokolluar nga ana jonë me shkresën nr.747 prot. datë 24.02.2024.
- II. Pakësohet fondi rezervë struktura 1110 llogaria 609 në vlerën 435,000 (katër qind e tridhjetë e pesëmijë) lekë dhe shtohet struktura 1110 llogaria 602 ne vlerën 435,000 (katër qind e tridhjetë e pesëmijë) lekë.
- III. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.


Drejtor Juridik
Ismet Saraci



Drejtor Ekonomik
Çeljeta Zuna



KRYETARI I BASHKISË



767 24/02/24

 **Gjinnazi "Fiqiri Dine" Maqellarë**

Nr. 916 Prot.

Maqellarë, më 19.02.2024

Lënda : Kërkesë për mbështetje financiare në Festivalin e XXIX Kulturor Folkloristik të Kalabrisë, Itali dhe Teknofest 2024 Stamboll, Turqi

Drejtuar: Këshillit Bashkiak

Peshkopi

Për dijëni: Z.Rahim Spahiu

Kryetar i Bashkisë Dibër

Të nderuar!

Po u shkruajmë këtë kërkesë në lidhje me pjesëmarrjen :

1. Festivali XXIX Kulturor Folkloristik të Kalabrisë, Itali
2. Teknofest 2024 Stamboll, Turqi

Angazhimi në institucione dhe organizma rinor krijon më shumë mundësi për t'u bërë një qytetar i ndërgjegjësuar dhe për të kontribuar për komunitetin në marrje vendimesh për projekte dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë kësaj periudhe kemi qenë të përkushtuar në promovimin e arsimit në aktivitete kombëtare dhe rajonale.

Gjinnazi "Fiqiri Dine" Maqellarë është shndëruar në lider i arsimit dibran dhe histori suksesi.

Ky sukses ka disa pika të forta;

- **Së pari**, ka tashmë një traditë të aktiviteteve të të gjitha llojeve që bëjnë që një gjinnaz të jetë një organizëm i tillë me emrin e nderuar Gjinnazi "Fiqiri Dine".
- **Së dyti**, staf pedagogjik janë ish- nxënësit më të mirë të gjinnazit me vlerësim shkëlqyeshëm, shumë mirë dhe tituj shkencor master e doktoraturë
- **Së treti**, është pjesë e programit Erasmus +, TeachPitch, e-Twinning, ...
- **Së katërti**, vënie në skenë e kryeveprave botërore
- **Së pesti**, bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, universitete, institucione, OJF, ...
- **Së gjashti**, zë i fortë në mbrojtjen nga bullizmi, dhuna në familje, mbështetjen e familjeve në nevojë, dhe promovimin e Dibrës si destinacion turistik.
- **Së shtati, Fitues të Çmimeve Kombëtare dhe Ndërkombëtare**
 - Vendi i 3-të "Vasha shqiptare" Ergi Kadria dhe Vendi 4-tërt "Pazari i Korçës" Arselina Illica në Konkursin "Shqiperia Ime"
 - Vendi 1-rë "Ta mbrojmë Plisin -UNESCO" Rezarta Gjeleshi, Prishtinë
 - Vendi i 2-të: "Unë qëndroj në Shqipëri " Rezarta Gjeleshi Konkursi Kombëtar i esesë.
 - Vendi i 2-të, Panairin " Dibra me aftësi të gjelbra" duke futur konceptin Eko Shkollë.
 - Vendi i 1-rë, Aljona Rustani dhe Laura Gjoni Konkursi "Jehona Shqiptare" Tiranë
 - Fitues National Steam Fair 2023 organizuar nga Universiteti BARLETI dhe pjesëmarrës TEKNOFEST 2024 Stamboll, Turqi.

“Exploring Dibra” në Panairin Virtual GEN- E 2023.

- **Së fundmi**, me moton “ Kërkues dhe frymëzues vazhdojmë rrugëtimin në
 1. Festivalin e Kalabrisë
 2. Teknofest 2024 Stamboll

me ogurin e mirë për të qenë promovues të denjë të Dibrës.

Jemi të bindur që këta projekte do të jenë një mundësi e mrekullueshme për të sfiduar, njohur, gjetur pasionet, ëndrrat dhe guximin tonë.

Besojmë se Gjymnazi “ Fiqiri Dine”, të cilin unë kam nderin ta drejtoj, na bën t’i përgjigjemi kohës, t’i përgjigjemi momentit të ri dhe mbi të gjitha t’i përgjigjemi një brezi gjimnazistësh, i cili kërkon një të ardhme tjetër, në një botë tjetër, për një Shqipëri tjetër.

Shprehim gatishmërinë që t’u nënshtrohemi të gjitha procedurave për mbështetje financiare nga Këshilli Bashkiak Dibër për përfaqësim dinjitoz në këta aktivitete ndërkombëtare.

Bashkëngitur keni projekt propozimet.

1. **Festivalin e XXIX Kulturor Folkloristik të Kalabrisë, Itali** --- 265'000 lekë
2. **Teknofest 2024 Stamboll, Turqi** --- 170'000 lekë

Ne do të jemi shumë mirënjohës, nëse ju na mbështetni financiarisht për të qenë pjesë e Festivali Kalabri dhe Teknofest 2024 Stamboll pasi bashkëpunimi me Arbëreshët e Italisë në promovimin e kulturës, muzikës , traditës, veshjes arbëreshe dhe shqiptare janë misioni ynë në vitin e gjuhës shqipe .


Në pritje të përgjigjes tuaj ...

Gjymnazi “ Fiqiri Dine “ Maqellarë mbetet derë e hapur bashkëpunimi.

Me respekt:

Drejtori

Edmir ASLLANI



FORMAT PROJEKT-PROPOZIMI


SEKSIONI I - INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI INSTITUCIONIN QË APLIKON

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME	
Emri i Institucionit/ Individit	Gjimnazi " Fiqiri Dine" Magellarë
Emri i titullarit të Institucionit/ individit	Edmir Asllani
Tel/Cel	0692154490
E-mail	edmirasllaniedas@gmail.com
Website/ Faqe në Facebook/	Gjimnazi " Fiqiri Dine" Magellarë, ZVA, Dibër
Adresa postare	Magellarë, Dibër
Statusi: Publik/Jopublik	Publik
Qyteti	Magellarë, Dibër
Personi i kontaktit për këtë projekt	Zamira Gjeleshi




SEKSIONI II - INFORMACION PËR PROJEKT-PROPOZIMIN E INSTITUCIONIT

Titulli i Projekt Propozimit	Teknofest Stamboll 2024 : Ora Blu e Drinit
Përshkrimi i përgjithshëm i projektit	<p>Gjinnazi "Fidiri Dine" është pjesë e Teknofest Stamboll 2024 me Projektin : Ora Blu e Drinit"</p> <p>Mendo globalisht, vepra lokalisht!</p> <p>Drini i Zi është aorta e Dibrës dhe gjithë Shqipërisë.</p> <p>Për një kohë të gjatë, ishte ende e mundur të thuhet "dubet më shumë shkencë" për të kuptuar se si saktësisht aktivitetet rrezore po dëmtonin botën natyrore.</p> <p>Jo më!</p> <p>Ndofta dhe përdorimi i lëndëve ka ndikime katastrofike jo vetëm në popullatat e kafshëve të egra, por edhe në shëndetin e njeriut dhe të gjitha aspektet e jetës sonë.</p> <p>Janë në zhdukje shumë lloje kafshësh si krapit, ngjala, deri i egër, ujku, artiu i murrinë, eji, prandaj identifikimi dhe përkujdesja na mundëson që biodiversiteti i basenit të Drinit të Zi të shndërrohet në atraksion turistik për Dibrën.</p> <p>Rezultat i projektit janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Orë mjedisore në Ditën e shkollës për Orën e Tokës 2. Presëmarrja në Panairin STEAM 2024 dhe Teknofest 2024 me maketin luginës së Drinit dhe kafshëve si dhe krijimi i tingujve për secilin prej tyre nëpërmjet kodimit. 3. Rafting nëlumin Drin. <p>Ky projekt është risi jo vetëm për Dibrën, por dhe për njësitë e tjera administrative të luginës së Drinit.</p> <p>Sot për Dibrën ka një sfida, ashtu sikurse ka edhe një vizion të qartë.</p> <p>Sfida jonë e përbashkët është konkrete: Bukuritë e Dibrës t'i ndajmë me njerëzoren në botë! Dibra nuk është vetëm për t'u vizituar, por shtëpia juaj!</p>



	<p>Projekt propozimi synon informimin dhe ndërgjegjësimin publik për vlerat e biodiversitetit dhe ekosistemit në luginën e Drinit të Zi.</p>
<p>Objektivat e Projektit</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të identifikohen peshqit, shpendët dhe gjarët e lumit Drin i Zi 2. Të risim ndërgjegjësimin për promovim të atraksioneve turistike dhe pastrimin e grykëderdhjeve të përrenjve në lumin Drin i Zi nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese dhe pjesëmarrjes në Panirin e Shkencës dhe Teknofest. 3. Të risim me 20% kontributin e të rinjve në zgjidhjen e problemeve nëpërmjet projekteve
<p>Rezultatet e priturme</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dita e shkollës për Orën e Tokës: Ora e Tokës dhe Dita e Tokës 2. Camping - <i>The time to act is now</i>, 23-30 Mars 2024 3. Maket "Ora Blu e Drinit" 4. Panairi Rajonal të Shkencës STEAM 2024, Tiranë, Shqipëri 5. Panairi TEKNOFEST 2024, Stamboll, Turqi <p>Rafting</p>
<p>Aktivitetet e parashikuara sipas secilit objektiv</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Angazhimi i komunitetit në marjen dhe ndajjen e informacionit 2. Dita e shkollës për Orën e Tokës 29 Mars 2024 dhe Ora e Tokës 30 Mars 2024 në Magellare 3. Rafting në lumin Drin si dhe fotografimi i kafshëve dhe pastrimi i grykëderdhjeve të përrenjve në lumin Drin 4. Maket i basentit të Drinit dhe kafshëve nëpërmjet tingujve 5. Pjesëmarrje në Panairin Rajonal të Shkencës STEAM 2024, Tiranë, Shqipëri 4. Pjesëmarrje në Panairin TEKNOFEST 2024, Stamboll, Turqi



Afajet kohore të zbatimit të projektit.		25-30 gusht 2024	
Grupi i synuar (Target group) i projektit.		7 Nxënës 3 Mësues	
Partnerët që do të përfshihen në projekt		Bashkia Dibrë Ekipi i Teknofest 2024	
Buxheti i parashikuar i projektit (në vlerë totale).		170'000 lekë	

Nr.	Produkti	Cmimi (lekë)	Sasia	Vlera (lekë)
1	Maketi Biodiversitetit të Luginës së Dritit të Zi	40.000	1	50.000
2	Baner	10.000	1	10.000
3	Bileta	10.000	10	100.000
4	Dhurata	5000	2	10.000
Totali				170'000

